



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Ilir META



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR
TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2016**

Pas shqyrtimit të raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtarinë e vitit 2016 dhe vlerësimit të çështjeve të ngritura në rapport në lidhje me:

- Organizimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të bashkive Dibër dhe Kolonjë;
- Shqetësimet e lidhura me raportet financiare të partive politike dhe auditimeve të fondeve të fushatave, që vijnë si pasojë e mungesës së rregullimeve ligjore në legjislacionin që rregullon veprimtarinë e partive politike;
- Problematikat e hasura nga KQZ-ja gjatë shqyrtimit të rasteve të lidhura me zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, përfshirë mënyrën e zgjidhjes së tyre nga KQZ-ja;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se KQZ-ja gjate vitit 2016:

- Ka realizuar në një pjesë të konsiderueshme kërkesa dhe detyrat e lëna nga Kuvendi, me rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015”;
- Ka monitoruar dhe zgjidhur në kohë problematikat e hasura gjatë proceseve të pjesshme zgjedhore për kryetar të bashkive Dibër dhe Kolonjë;
- Për herë të parë është përballur me trajtimin e çështjeve që kishin lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Me gjithë vështirësitë në zbatim, për shkak të paqartësive dhe boshllëqeve në ligj për sa i takon trajtimit të rasteve të ndryshme, KQZ-ja ka interpretuar dhe ka vendosur drejt, duke vlerësuar se individët që janë subjekt i këtij ligji duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve të parashikuara

nga ky ligj dhe që përbëjnë ndalim për të kandiduar, për t'u zgjedhur ose emëruar. Qëllimi i ligjit nr. 138/2015, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të atyre personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t'u zgjedhur, apo emëruar, por jo të personave që, për një arsy që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme apo të paplota në raport me të dhënat e gjendura në regjistrat publikë, të cilët janë regjistra zyrtarë e që nuk plotësohet me vetëdeklarim, por sipas procedurave të posaçme ligjore, apo të tjerë që kanë deklaruar të dhëna shtesë pas përfundimit të afatit të deklarimit.

Në këto kushte, duke konsideruar që viti në vazhdim është vit zgjedhor, Komisioni Qendorr i Zgjedhjeve duhet të fokusohet kryesisht në ato drejtime që kanë të bëjnë me funksionet unike të Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve në një vit zgjedhor.

Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve fokusimin në këto drejtime:

- Duke konsideruar që viti 2017 është vit zgjedhor, në të cilin organizohen zgjedhjet parlamentare të radhës, rekomandohet angazhim maksimal i të gjitha njësive dhe strukturave të KQZ-së për organizimin e një procesi para dhe pas zgjedhor me standarde të larta;
- Angazhimin maksimal në funksionet që kanë lidhje me procesin e dekriminalizimit dhe me zbatimin e ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për sa i takon verifikimit të kandidatëve për zgjedhjet e përgjithshme, duke qenë ky një proces shumë i rëndësishëm në themel të cilësisë së Kuvendit të ardhshëm;
- Të përfundohet zhvillimi i moduleve/programeve kompjuterike dhe të kryhet instalimi dhe testimi paraprak i tyre, për t'u përdorur në zgjedhjet e Kuvendit 2017.
- Të marrë masa për zbatimin të vendimit për "Miratimin e planit Orientues të veprimeve", në funksion të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, duke konsideruar që Plani Orientues i Veprimeve është një kornizë udhëzuese për veprimet dhe aktet nënligjore, mbi të cilat do të mbështetet aktiviteti i mëtejshëm i KQZ-së.
- Në funksion të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, në bashkëveprim me Drejtoren e Përgjithshme të Gjendjes Civile,
 - të referojë zbatimin e problematikave të vërejtura lidhur me listat e zgjedhësve; si dhe
 - të shqyrtojë e të monitorojë masat e marra nga administrata e gjendjes civile.
- Është i rëndësishëm fillimi i një vlerësimi të plotë nga ana e Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve për votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në emigracion, në lidhje me hapat që duhen ndërmarrë dhe metodologjinë që duhet zbatuar, me synim lehtësimin dhe garantimin e së drejtës kushtetuese të tyre për të votuar, rekomandim ky që është dhënë edhe më parë me rezolutën e vitit 2015.

Miratuar në datën 20.4.2017